



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.78

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9569 datë 3.7.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ndërkombëtar rrugor”	2227
Ligj nr.9570 datë 3.7.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar.....	2233
Ligj nr.9571 datë 3.7.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin rajonal CARDS 2005””	2237
Ligj nr.9572 datë 3.7.2006	Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.....	2252

L I G J
Nr. 9569, datë 3.7.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ndërkombëtar rrugor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4985, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË
SË BELGJIKËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR**

Qeveritë e Republikës së Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Belgjikës, të quajtura më poshtë Palë Kontraktuese, me synimin për të krijuar mundësi më të mira për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet dy vendeve dhe krijimin e lehtësirave të kënaqshme për transportin e mallrave dhe udhëtarëve:

duke pasur parasysh procesin europian të liberalizimit, i cili kontribuon në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe të njerëzve;

duke konsideruar çështje bazë mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e trafikut, kanë rënë dakord si më poshtë.

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve për të tretë ose me shpërblim ose për llogari të vet ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese, në transit përmes territoreve të tyre dhe për në ose nga vende të treta, të kryera nga operatorë transporti të vendosur në territorin e njërit nga Palët Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese do të garantojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të arritura ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshje të tjera multilaterale të nënshkruara nga të dyja Palët.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “operatorë transporti” nënkupton një person (përfshirë një person juridik), i cili është i vendosur në territorin e një Pale Kontraktuese dhe pranohet ligjërisht në vendin e vendosjes në tregun e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave ose udhëtarëve për të tretë ose me shpërblim, ose për llogari të vet në përputhje me ligjet dhe rregullat e caktuara kombëtare.

2. Termi “mjet” nënkupton një mjet motorik të regjistruar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese ose një kombinim i mjeteve nga të cilat të paktën mjeti motorik është i regjistruar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese dhe që përdoret, dhe është i pajisur veçanërisht për transportin e mallrave ose transportin e udhëtarëve.

3. Termi “autobus” nënkupton një mjet për transportin e udhëtarëve i cili është i përshtatshëm nga konstruksioni dhe pajisja e tij për transportin e më shumë se nëntë personave, duke përfshirë shoferin dhe është i destinuar për këtë qëllim.

4. Termi “transport” nënkupton lëvizjen në rrugë të mjeteve të ngarkuara ose të pangarkuara, edhe në qoftë se për një pjesë të udhëtimit, mjeti, traileri ose gjysmëtraileri përdor hekurudhat ose rrugët ujore.

5. Termi “shërbim i rregullt” nënkupton një shërbim me autobus, i cili siguron transport udhëtarësh sipas një frekuence të caktuar dhe në një linjë të caktuar, gjatë së cilës udhëtarët mund të merren ose zbriten në stacione të paracaktuara. Një shërbim i rregullt mund të jetë objekt i detyrimit për të respektuar orare dhe tarifa të vendosura më parë.

Një shërbim i rregullt do të jetë i hapur për të gjithë dhe kur gjykohet e përshtatshme, do t'i nënshtrohet kushteve të detyrueshme.

6. Termi “shërbim i rregullt i posaçëm” nënkupton një shërbim autobusi, i organizuar nga kushdo, që siguron transportin e një kategorie të caktuar udhëtarësh me përjashtim të udhëtarëve të tjerë, për më tepër një shërbim i tillë kryhet sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 5.

Shërbimet e rregullta të posaçme do të përfshijnë:

- Transportin punë-shtëpi të punonjësve;
- Transportin e nxënësve të shkollave dhe studentëve për në dhe nga institucionet edukuese.

Fakti që një shërbim i rregullt i posaçëm mund të ndryshojë në përputhje me nevojat e përdoruesve nuk do të ndikojë në klasifikimin e tij si një shërbim i rregullt.

7. Termi “shërbimi vajtje-ardhje” nënkupton një shërbim me autobus, me anë të të cilit, nëpërmjet udhëtimeve të përsëritura vajtje-ardhje, transportohen grupe udhëtarësh të formuar më parë, nga një vend i vetëm nisjeje te një destinacion i vetëm. Çdo grup, që përbëhet nga udhëtarë të cilët bëjnë udhëtimin në vajtje, do të transportohet përsëri në vendin e nisjes në një udhëtim të mëpasëm nga i njëjti operator transporti. Vendi i nisjes dhe i destinacionit, respektivisht, do të nënkuptojnë vendin ku fillon udhëtimi dhe vendin ku mbaron udhëtimi, në secilin rast, bashkë me lokalitetin përreth, brenda një rrezeje 50 km.

Në itinerarin e një shërbimi vajtje-ardhje, asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbritet gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë në kthim dhe i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje do të bëhet bosh.

“Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim” përfshin krahas transportit edhe akomodimin për të paktën 80% të udhëtarëve me ushqim ose pa ushqim, në vendin e destinacionit dhe kur është e nevojshme, gjatë udhëtimit. Udhëtarët do të qëndrojnë në vendin e mbërritjes për të paktën 2 netë.

Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim mund të kryhet nga një grup operatorësh transporti që veprojnë në emër të të njëjtit kontraktor dhe udhëtarët:

- ose mund të kryejnë udhëtimin e kthimit me një transportues tjetër, prej të njëjtit grup, nga udhëtimi i vajtjes;

- ose mund të kapin një linjë “gjatë udhëtimit” me një transportues tjetër, prej të njëjtit grup.

8. Termi “shërbim i rastit” nënkupton një shërbim me autobus ndërmjet territoreve të Palëve Kontaktuese që nuk mund të jetë as brenda përkufizimit të një shërbimi të rregullt ose një shërbimi të rregullt të posaçëm, as përkufizimit të një shërbimi vajtje-ardhje. Një shërbim i tillë mund të kryhet me disa shkallë frekuence pa pushtuar së qenuri në këtë mënyrë një shërbim i rastit.

Shërbimet e rastit përfshijnë:

a) Udhëtimet me dyer të mbyllura, domethënë shërbimet, me anë të të cilave i njëjti mjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe kthimin mbrapa në vendin e nisjes, i cili është vendi ku mjete është i regjistruar;

b) Shërbimet, të cilat kryejnë udhëtimin në vajtje plot dhe udhëtimin në kthim bosh;

c) Shërbimet, të cilat kryejnë udhëtimin në vajtje bosh dhe udhëtimin në kthim plot, me udhëtarë të marrë në të njëjtën pikë të vendit ku mjete nuk është i regjistruar, me kusht që udhëtarët:

- të përbëjnë një grup të formuar më parë sipas një kontrate të transportit të përfunduar para mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë, ose

- të jenë sjellë më parë nga i njëjti transportues sipas kushteve të rastit b, dhe me kusht që ata të jenë marrë përsëri dhe të jenë transportuar mbrapsht në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit;

- të jenë ftuar për të udhëtuar në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit ku kostoja e transportit përballohet nga personi që ka lëshuar ftesën. Udhëtarë të tillë duhet të përbëjë një grup homogjen, i cili ka qenë formuar vetëm për këtë udhëtim të veçantë.

9. Termi “transporti për llogari të vet” nënkupton:

a) Në rastin e transportit të udhëtarëve, ku transporti kryhet për qëllim jotregtare dhe jofitimprurëse nga operatorët e transportit, me kusht që:

- aktiviteti i transportit është vetëm një aktivitet ndihmës për operatorin e transportit;

- automjetet që përdoren janë në pronësi të operatorit të transportit ose të vendosura në dispozicion të tij nëpërmjet një kontrate me qira ose leasing dhe drejtohen nga anëtarë të personelit të operatorit të transportit ose nga vetë operatori i transportit;

b) Në rastin e transportit të mallrave, ku mallrat e transportuara janë pronë e operatorit të transportit ose janë shitur, blerë, të dhëna me qira ose të marra në qira, të prodhuara, të nxjerra, të përpunuara ose riparuar nga operatori i transportit. Qëllimi i transportit duhet të jetë transporti i mallrave për në ose nga ambientet e operatorit të transportit ose për t'i lëvizur ato, ose brenda ambienteve të operatorit të transportit ose jashtë për kërkesat e veta. Automjetet e përdorura për këtë transport duhet të drejtohen nga anëtarët e personelit të operatorit të transportit ose nga vetë operatori i transportit dhe të jenë pronë e operatorit të transportit ose të vëna në dispozicion të tij nëpërmjet një kontrate me qira ose leasing. Transporti duhet të jetë një aktivitet ndihmës i operatorit të transportit.

Neni 3

Hyrja në treg

Çdo Palë Kontraktuese duhet të lejojë cilindo operator transporti të vendosur në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të kryejë transport mallrash dhe udhëtarësh:

a) ndërmjet çdo pike në territorin e tij dhe çdo pike jashtë atij territori, dhe

b) në transit përmes territorit të tij, të cilat do të jenë subjekt për leje ose autorizime, të lëshuara nga autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 4
Pesha dhe përmasat

1. Peshat dhe përmasat e mjeteve duhet të jenë në përputhje me regjistrimin zyrtar të mjetit dhe nuk duhet të kapërcejnë limitet në fuqi në vendin pritës.

2. Një leje e veçantë e lëshuar nga një autoritet kompetent kërkohet në qoftë se peshat dhe/ose përmasat e mjetit të ngarkuar ose të pangarkuar i angazhuar në transport sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje e kapërcejnë maksimum e lejuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5
Përshtatja me legjislacionin kombëtar

Operatorët e transportit të një Pale Kontraktuese dhe ekipet e mjeteve të tyre, kur janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi në atë vend.

Neni 6
Shkeljet

Në rastin e ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga një transportues i një Pale Kontraktuese, Pala Kontraktuese në territorin e të cilës kryhet shkelja, mundet, pa paragjykim për procedimin e saj ligjor, t'ia njoftojë këtë shkelje Palës tjetër Kontraktuese, e cila do të ndërmarrë hapa të cilat janë parashikuar nga ligjet kombëtare, duke përfshirë tërheqjen e lejes ose autorizimet ose ndalimin për të kryer transporte në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Këto Palë Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën rreth sanksioneve që kanë vendosur.

Neni 7
Çështjet financiare

1. Mjetet, duke përfshirë pjesët e tyre të këmbimit, që janë të angazhuara në operacione transporti në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, do të përjashtohen reciprokisht nga të gjitha taksat dhe detyrimet e vendosura në qarkullimin ose pronësinë e mjeteve.

2. Nuk përjashtohen taksat dhe detyrimet mbi karburantin e motorit, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në operacionet e transportit, detyrimet (pagesat e segmenteve të veçanta rrugore, urave) dhe taksat e përdorimit, dhe taksat për leje të veçanta ashtu si parashikohet në nenin 4.

3. Karburanti i vendosur në depozitat normale të mjetit të ndërtuar për këtë qëllim dhe që përdoret për funksionimin e mjetit ose për funksionimin e pajisjeve për kontrollin e temperaturës, ashtu si dhe lubrifikantët e vendosur në mjete me qëllimin e vetëm, funksionimin e tyre, do të jenë reciprokisht të përjashtuar nga detyrimet doganore dhe çdo taksë dhe pagesë tjetër.

4. Pjesët e ndërrimit të kërkuara për riparimin e një mjeti tashmë të importuar do të lejohen përkohësisht nën emrin e importimit të përkohshëm pa pagesë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera, dhe pa pengesa dhe kufizime të importit. Pjesët e zëvendësuara duhet të çdoganohen, rieksporohen ose shkatërrohen nën kontrollin dhe vëzhgimin doganor.

Neni 8
Komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të rregullojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përdorimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Për këtë qëllim Palët Kontraktuese do të ngrejnë një komitet të përbashkët.

3. Komiteti i përbashkët do të mbledhet rregullisht me kërkesë të njëjës Palë Kontraktuese reciprokisht në territorin e njëjës prej Palëve Kontraktuese dhe do të ketë përfaqësues të autoriteteve kompetente të administratës së Palëve Kontraktuese, të cilat mund të ftojnë përfaqësues të shoqatave të transportit rrugor.

4. Komiteti i përbashkët duhet të përcaktojë procedurat dhe rregullat e veta. Takimi duhet të përfundojë me hartimin e një protokollit që do të firmoset nga kryetarët e delegacioneve të secilës Palë kontraktuese.

5. Në vazhdim të nenit 3, komiteti i përbashkët do të vendosë për numrin dhe tipin e lejeve ose autorizimeve dhe kushtet e hyrjes në treg. Pavarësisht nga neni 12 paragrafi 2, komiteti i përbashkët mund të zgjerojë llojet e transportit për të cilat nuk kërkohen leje ose autorizime.

6. Komiteti i përbashkët do të tregojë vëmendje të veçantë për çështjet e mëposhtme:

- Zhvillimin e harmonizuar të transportit ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke pasur parasysh ndërmjet të tjerave aspektet mjedisore të përfshira;

- Koordinimin e politikave të transportit, legjislacionit të transportit dhe zbatimin e tij nga Palët Kontraktuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Formulimin e zgjidhjeve të mundshme për autoritetet respektive kombëtare nëse ka probleme, veçanërisht në fushën e çështjeve fiskale, sociale, doganore dhe mjedisore, duke përfshirë çështjet e rendit publik që ndikojnë në operimet e transportit;

- Shkëmbimin e informacionit përkatës;

- Metodën e përcaktimit të përmasave dhe peshave;

- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të transportit;

- Nxitjen e transportit të kombinuar, që përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me hyrjen në treg.

PJESA II DISPOZITA PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

Neni 9 Shërbimet e rregullta

1. Aplikimet për autorizime për shërbimet e rregullta do të dorëzohen pranë autoriteteve kompetente në vendin e territorin e të cilit është vendosur pika e nisjes.

2. Vendimi për të lëshuar autorizime do të ndërmerret bashkërisht nga autoritetet e Palëve Kontraktuese. Ato lëshohen nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese, secila për territorin e saj.

3. Një aplikim për një autorizim mund të refuzohet nëse, ndër të tjerash:

- aplikuesi e ka të pamundur të sigurojë shërbimin e cili është subjekt i aplikimit me pajisjet që ai ka direkt në dispozicion të tij;

- në qoftë se në të kaluarën aplikuesi nuk ka zbatuar legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe në veçanti kushtet dhe kërkesat që lidhen me autorizimet për shërbimet e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve ose ka kryer thyerje serioze të legjislacionit në lidhje me sigurinë rrugore, në veçanti përsa i takon rregullave të zbatueshme për mjetet dhe drejtimin dhe periudhën e pushimit të shoferave;

- në qoftë se, në rastin e një aplikimi për rinovimin e autorizimit, kushtet e autorizimit nuk janë zbatuar.

4. Një vendim nëse një autorizim do të lëshohet, do të ndërmerret nga autoritetet kompetente brenda tre muajve nga data në të cilën është marrë një aplikim i plotë.

5. Një autorizim do të jetë i vlefshëm për një periudhë maksimale prej tre vitesh dhe mund të zgjatet me kërkesë.

6. Autorizimi ose një kopje e tij e legalizuar do të mbahet në mjet.

Neni 10
Shërbimet vajtje-ardhje

1. Nuk do të kërkohet autorizim për shërbimet vajtje-ardhje me akomodim të kryer nga operatorët e transportit shqiptar ose operatorët e transportit belg nëse këto shërbime e kanë nisjen e tyre respektivisht në Shqipëri dhe Belgjikë.

2. Shërbimet vajtje-ardhje pa akomodim trajtohen si shërbime të rregullta.

3. Për shërbimet vajtje-ardhje të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, do të përdoret dokumenti i udhëtimit të udhëtarëve i plotësuar tërësisht.

Neni 11
Shërbimet e rastit

Nuk do të kërkohet autorizim për shërbimet e rastit që klasifikohen sipas nenin 2.8 a), b) dhe c) nëse plotësohen kushtet. Shërbimet që klasifikohen sipas nenit 2.8 d) janë subjekt autorizimi.

Një dokument udhëtimi i udhëtarëve, i plotësuar tërësisht, do të mbahet në mjet.

PJESA III
DISPOZITAT PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE

Neni 12
Kushtet e lejes

1. Lejet për transportin e mallrave do të lëshohen brenda kufijve të një kuote për 1(një) udhëtim (vajtje-ardhje) ose secila për 1(një) vit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 13-mujore, duke filluar që nga 1 janari i çdo viti kalendarik. Lejet do të mbahen në mjet.

2. Lejet janë personale dhe nuk janë të transferueshme te palë të treta.

3. Lejet mund të përdoren vetëm njëherë për një makinë.

4. Komiteti i përbashkët referuar në nenin 8 përcakton kuotën, kategoritë e lejeve (udhëtimin dhe kohën) dhe çdo kusht tjetër që kontrollojnë përdorimin e lejes.

5. Nuk do të kërkohet leje ose autorizim për llojet e mëposhtme të transportit ose për udhëtimet bosh të kryera në lidhje me transporte të tilla si:

a) Transporti i mallrave me automjete, pesha totale e lejuar e ngarkesës (TPLW) e të cilave, duke përfshirë trailerat, nuk i kalon 6 tonët, ose kur ngarkesa e lejuar e mallit, duke përfshirë trailerat, nuk i kalon 3.5 tonët;

b) Transporti i mallrave, mbi një bazë të rastësishme, për në ose nga aeroportet, në rastet kur shërbimet janë devijuar;

c) transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose kanë difekte dhe transporti i mjeteve për riparimin e difekteve;

d) Udhëtimet pa ngarkesë të një mjeteve mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet i cili ka pësuar difekt në një vend tjetër, si dhe udhëtimi i kthimit, pas riparimit të mjetit që kishte difekt;

e) Transporti i gjësë së gjallë në mjete të ndërtuara për këtë qëllim ose përkohësisht të konvertuara për transportin e gjësë së gjallë dhe të njohura si të tilla nga autoritetet e interesuara të Palëve Kontraktuese;

f) Transporti i pjesëve të këmbimit dhe i rezervave për anijet transoqeanike dhe për avionët;

g) Transporti i furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për urgjenca, në veçanti në rastet e katastrofave natyrore dhe nevojave humanitare;

h) Transporti i punimeve dhe objekteve të artit për panairë dhe ekspozita për qëllime jotregtare;

i) Transporti për qëllime jotregtare i rekuizitave, aksesorëve dhe kafshëve për në ose nga shfaqje teatrale, muzikore, filma, sporti ose cirku, panaire ose festivale, dhe ato për qëllim regjistrimi radiofonik, ose për filma ose prodhime televizive;

j) Transporti i mallrave për llogaritë vet;

k) Transporti funeral;

l) Transporti i postës, i kryer si një shërbim publik;

6. Leja duhet të plotësohet para fillimit të udhëtimit. Dokumenti duhet të vuloset nga doganat në kohën e hyrjes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Kur kufiri kalohet në një vend ku nuk ka dogana, shoferi duhet të shkruajë me bojë në leje, në vendin e vulës së doganës, vendin, datën dhe orën e kalimit të kufirit.

7. Në përputhje me nenin 4 paragrafi 2, kërkesa për një autorizim të veçantë për mjetet që transportojnë mallra, pesha dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë e lejuar në territorin e Palës Kontraktuese pritëse, duhet të përmbajë:

1. Emrin dhe adresën e operatorit;

2. Prodhuesin e mjetit, tipin dhe targat;

3. Numrin e akseve dhe shpërndarjen e akseve;

4. Përmasat dhe peshën e mjeteve;

5. Kapacitetin e ngarkimit;

6. Përmasat dhe peshën e mallrave;

7. Në qoftë se është e nevojshme, përshkrimin e mjetit së bashku me mallrat;

8. Ngarkesën për çdo aks;

9. Adresa e vendit të ngarkimit dhe shkarkimit;

10. Vendin e planifikuar të kalimit kufitar, datën, si dhe itinerarin.

PJESA IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët Kontraktuese kanë informuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që janë plotësuar kërkesat ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes në vendet e tyre respektive.

2. Palët Kontraktuese mund ta përfundojnë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke njoftuar me shkrim gjashtë muaj më parë Palën tjetër Kontraktuese.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze në.....

L I G J
Nr. 9570, datë 3.7.2006

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 7995, DATË 20.9.1995 “PËR
NXITJEN E PUNËSIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2
Përkufizime

1. Në qoftë se në këtë ligj nuk parashikohet ndryshe, përcaktimet e bëra në Kodin e Punës përdoren edhe për këtë ligj.

2. “Ministër” është Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. “Ministri” është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. “Person” është një person fizik, siç përcaktohet në Kodin Civil.

5. “Ndërmarrje” është një person juridik, siç përcaktohet në Kodin Civil.

6. “Punëdhënës” janë ndërmarrjet dhe personat, që u sigurojnë personave të tjerë një punësim të paguar, me një kontratë punësimi.

7. “Punësim” është punësimi i përshtatshëm, fitimprurës dhe i zgjedhur lirisht.

8. “Punësim i përshtatshëm” është punësimi i paguar i një personi, në përputhje me moshën, gjininë, kushtet shëndetësore, arsimimin, formimin profesional, vendbanimin, kohëzgjatjen e punësimit të mëparshëm, përvojën e fituar, ndikimin e punës në fjalë në gjendjen personale dhe familjare dhe gjendjen e tregut të punës. Rastet kur vendi i punës është vakant, si rezultat i drejtpërdrejtë i pushimit të marrëdhënieve të punës për shkak të një mosmarrëveshjeje, e cila është në vazhdim, nuk përfshihen në përkufizimin “punësim i përshtatshëm”.

9. “Person i vetëpunësuar” është personi që kryen një veprimtari të autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë, për llogari të tij, në shkëmbim të një pagese ose forme tjetër shpërblimi.

10. “Person i papunë” është personi, shtetas i Republikës së Shqipërisë, në moshë pune, që nuk punon dhe nuk ushtron veprimtari si i vetëpunësuar.

11. “Punëkërkues” është çdo person i papunë, i disponueshëm për punësim, i cili paraqitet periodikisht në zyrën përkatëse të punësimit, përfshirë edhe personat, të cilët janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, por që kërkojnë një punë të re.

12. “Shërbime punësimi” janë shërbimet, të cilat synojnë të informojnë, të këshillojnë, të orientojnë dhe të ndërmjetësojnë punëkërkues të papunë për vendet e lira të punës, të ofruara nga punëdhënësit.

13. “Ndërmjetësim për punësim” janë shërbimet, që kryhen për t'i gjetur një vend të përshtatshëm pune një punëkërkuesi, formimi, aftësitë dhe cilësitë e të cilit përputhen me kërkesat e deklaruara nga punëdhënësi për këtë vend pune.

Ndërmjetësim për punë vlerësohet dhe rasti kur, në zbatim të marrëveshjeve ose lejeve të posaçme, mundësohet punësimi i punëkërkuarve shqiptarë jashtë shtetit.

14. “Politika të tregut aktiv të punës” janë format e përcaktuara të ndërhyrjes qeveritare për mirëfunksionimin e këtij tregu dhe për të ulur papunësinë.

15. “Riaftësim profesional” është ajo pjesë e procesit të riaftësimit, ku përfshihet përgatitja profesionale e personave me aftësi të kufizuara, për t'i bërë ata të aftë të sigurojnë dhe të mbajnë një punë të përshtatshme.

16. “Person me aftësi të kufizuara” është personi, mundësitë e të cilit për të gjetur dhe mbajtur një vend të përshtatshëm pune janë zvogëluar në mënyrë të ndjeshme, si rezultat i aftësisë së kufizuar të tij për punë, e deklaruar kjo me vendime të komisioneve mjekësore përkatëse, sipas kritereve të vendosura në legjislacionin në fuqi.

17. “Politika shtetërore të punësimit” janë programet dhe projektet qeveritare, të cilat synojnë nxitjen e punësimit.

18. “Zyra e punësimit” është zyra, rajonale ose vendore, e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

19. “Zyra përkatëse e punësimit” është:

a) zyra shtetërore e punësimit, e cila kryen veprimtari në zonën e vendbanimit të përhershëm të personit, që pretendon të përfitojë një vend pune, shërbime punësimi, formim profesional apo mbështetje me të ardhura;

b) zyra shtetërore e punësimit, e cila kryen veprimtari në zonën ku punëdhënësi ushtron veprimtarinë e vet.

20. “Grupe të veçanta” janë punëkërkuarët, si: nënat me shumë fëmijë, personat me moshë mbi 50 vjeç, të rinjtë nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, viktimat e trafikut, personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura, personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi, vajzat-nëna të papuna, femrat e divorcuara me probleme sociale, personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike, personat e sapodiplomuar, të paorientuar në tregun e punës, personat që kanë vuajtur dënimin me burgim, personat me aftësi të kufizuara, romët, jetimët që e kanë fituar këtë status.

21. “Punë publike” janë veprimtari që kërkojnë aftësi profesionale minimale, që realizohen, kryesisht, nëpërmjet punës së krahut, por që sjellin përfitim të dukshëm për komunitetin ku zhvillohen dhe kanë karakter të përkohshëm.

22. “Praktikat profesionale (stazhi)” janë veprimtaritë e formimit nëpërmjet punës të punëkërkuarve, të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë, brenda ose jashtë vendit, në ndërmarrje apo institucione private ose publike.”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. I njëjti trajtim, sipas pikës 2 të këtij neni, u sigurohet të huajve, që vijnë nga vende të cilat nuk kanë një marrëveshje të tillë me Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Politikat aktive të tregut të punës përfshijnë:

- a) shërbimet e punësimit;
- b) programet e krijimit të vendeve të reja të punës;
- c) programet e formimit profesional.”.

Neni 4

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Shërbimet e punësimit

1. Shërbimet e punësimit përfshijnë veprimtaritë:
 - a) e informimit për vendet e lira të punës;
 - b) e ndërmjetësimeve për punësim;
 - c) e këshillimit dhe orientimit për punë dhe profesion.
2. Shteti krijon dhe mban organizma të posaçëm, që ofrojnë, pa pagesë, shërbime punësimi në të gjithë territorin e vendit.”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Ndërmjetësimi për punësim

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit garanton, pa pagesë, ndërmjetësimin për punë për punëdhënësit dhe punëkërkuarit në të gjithë territorin e vendit. Shteti mbështet pajisjen dhe përgatitjen e posaçme të zyrave të punësimit, për të kryer ndërmjetësim për punë cilësore dhe efektive.
2. Zyrat e punësimit, në përcaktimin e kandidatëve për plotësimin e vendeve të lira të punës, u japin përparësi:
 - a) punëkërkuarëve nga grupe të veçanta;
 - b) punëkërkuarëve të papunë afatgjatë;
 - c) punëkërkuarëve të tjerë.
3. Kriteret, që duhet të plotësojnë personat juridikë ose fizikë privatë për t'u licencuar për ushtrimin e veprimtarive në fushën e shërbimeve të punësimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Këshillimi dhe orientimi për profesion dhe punësim

1. Këshillimi dhe orientimi për profesion dhe punësim ka për qëllim t'i ndihmojë punëkërkuarit në zgjedhjen dhe formimin e tyre në një profesion të përshtatshëm me cilësitë individuale dhe të kërkuar në tregun e punës.
2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit kryen, pa pagesë, këshillim dhe orientim për profesion dhe punësim për punëkërkuarit në të gjithë territorin e vendit.”.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9
Praktikat profesionale (stazhi)

1. Punëkërkuetit, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë, brenda ose jashtë vendit, marrin pjesë në programe praktikash profesionale (stazhe).

2. Punëdhënësit, që marrin në mjediset e ndërmarrjes apo të institucioneve të tyre persona, sipas pikës 1 të këtij neni, për të kryer praktikat profesionale, mund të financohen nga zyra përkatëse e punësimit.

3. Institucionet publike e ofrojnë falas këtë shërbim.

4. Punëkërkuetit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të mbështeten financiarisht, sipas kriterëve të vendosura, gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale.

5. Masat, kriteret dhe procedurat për zbatimin e këtij programi përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 8

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë i pikës 5 ndryshohet si më poshtë:

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit zbaton programet shtetërore për formimin profesional dhe ofron”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Zyrat e punësimit mbështesin financiarisht, në bazë procedurash konkurrimi, organizimin e kurseve të formimit profesional, të organizuara nëpërmjet institucioneve të formimit profesional, publike ose private. Procedurat për zhvillimin e konkurrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Në pikën 6, pas fjalës “Kriteret” shtohen fjalët “dhe procedurat”.

Neni 9

Në pikën 1 të nenit 12, fjalët “kanë të drejtë për” zëvendësohen me fjalët “përfitojnë gjatë kësaj periudhe”.

Neni 10

Pika 2 e nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“2. Statuti i Shërbimit Kombëtar të Punësimit përcakton:

- a) mënyrën e organizimit, strukturat dhe kompetencat;
- b) mënyrën e funksionimit, të drejtimit dhe të administrimit;
- c) mënyrën e financimit.”.

Neni 11

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19
Këshillat vendorë tripalësh

Zyra e punësimit e ushtron funksionin në konsultim me këshillin vendor tripalësh. Të drejtat, detyrat dhe përbërja e këshillit vendor tripalësh përcaktohen nga këshilli administrativ tripalësh i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.”.

Neni 12

Në pikën 2 të nenit 20 bëhen këto ndryshime:

1. Në rreshtin e parë, fjalët “do të jenë:” zëvendësohen me fjalët “përbëhen nga:”.
2. Në shkronjën “a” fjala “popullor” zëvendësohet me fjalët “i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 13

Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 24, fjalët “në kompetencë të tyre” zëvendësohen me fjalët “të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në territorin, që është në kompetencë të saj”.

Neni 14

Neni 28 “Dispozita të përkohshme” shfuqizohet.

Neni 15

Kudo në ligj fjala “kompetente”, pas fjalëve “zyra”, “zyrës” dhe “zyrën”, zëvendësohet me fjalën “përkatëse”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4986, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J

Nr. 9571, datë 3.7.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE “PËR PROGRAMIN RAJONAL CARDS 2005””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin rajonal CARDS 2005””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4987, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE KUSHTET SPECIALE

Komuniteti European, këtu e tutje referuar si “Komuniteti”, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si “Komisioni”, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si “Përfituesi”, nga ana tjetër, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Natyra dhe qëllimi i veprimit

1.1. Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit CARDS Rajonal 2005, këtu e tutje referuar si “Programi”, i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2. Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj: Kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe Dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Neni 2

Kontributi financiar i komunitetit

2.1 Kostoja totale e programit është 47.9 milionë euro.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin e shumës 47.9 milionë euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit sipas zërave të buxhetit është përshkruar në buxhetin e përfshirë në Dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3

Kontributi i përfituesit

Aty ku, një pjesë apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në një memorandum mirëkuptimi të veçantë në lidhje me çdo program/projekt.

Neni 4

Periudha e ekzekutimit

Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë, e shumta, në datën 31.12.2014. Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën 31.12.2012. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së ekzekutimit.

Neni 5

Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 24.11.2008. Ky afat nuk mund të shtyhet. Kjo normë nuk aplikohet mbi kontratat e auditimit dhe vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen më vonë.

Neni 6

Adresat

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes financiare do të jenë të shkruara, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin
Z. Dirk Meganeck
Drejtor
Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit
CHAR 04/99
B-1049 Bruksel, Belgjikë
Fax: +32 2 295 74 82

b) për Përfituesin
Znj. Arenca Trashani
Ministër i Integrimit Europian
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 25 62 67

Neni 7 **Shtojcat**

7.1. Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje dhe do të përbëjnë pjesë integrale të saj:

Shtojca I: Kushtet e përgjithshme

Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative

7.2. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve speciale të Marrëveshjes financiare, dispozitat e kushteve speciale do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8 **Kushte të tjera speciale të zbatueshme për programin**

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

Me qëllim që të sigurohet një zbatim efektiv i kësaj Marrëveshjeje financiare, Përfituesi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- Ekspertët e kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e programit lidhur me këtë Marrëveshje financiare do të gëzojnë mbrojtjen e tij dhe do t'u jepen lejekalimi të nevojshme për të bërë të mundur lëvizjen e lirë të tyre brenda territorit të Shqipërisë.

- Të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtarë të afërt të familjeve të tyre do t'u akordohen përfitime jo më pak të favorshme, privilegje dhe përjashtime si ato që i akordohen zakonisht të punësuarve të tjerë të stafit ndërkombëtar në Shqipëri sipas çdo marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe për ndihmë ekonomike.

- Të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre t'u lejohet hyrja në Shqipëri për t'u vendosur për të punuar dhe për t'u larguar nga Shqipëria ashtu siç parashikohet në kontratë.

- Të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve për këtë program, si dhe lejet e kërkuara për riekportimin e po të njëjtave sende do të jepen.

- Të gjitha importet e kryera nën këtë Marrëveshje financiare do të përjashtohen nga taksat e doganave, detyrimet eksportuese ose taksa dhe ngarkesa të tjera fiskale.

- Të gjitha prokurimet publike të pajisjeve dhe shërbimeve të zhvilluara nën këtë Marrëveshje financiare do të përjashtohen nga taksat e shitjeve ose tarifave të tjera fiskale të të njëjtës natyrë.

- Në të gjitha këto raste, Përfituesi do të sigurojë bashkëpunim të plotë me autoritetet përkatëse.

- Përveç të tjerash, Përfituesi do të sigurojë akses në kompanitë shtetërore dhe institucione të tjera qeverisëse, të cilat do të përfshihen ose janë të nevojshme për implementimin e programit.

Në rast vështirësish në zbatimin e programit, palët bien dakord të konsultohen menjëherë, me qëllim që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për t'i zgjidhur këto vështirësi.

Importi dhe riekportimi i pajisjeve

Përfituesi duhet të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për të ekzekutuar masat që u nënshtrohen ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregulloreve të marrësit.

Përfituesi duhet t'u japë personave fizikë dhe juridikë që kanë ofruar punime, pajisje ose kontrata shërbimesh, lejet e kërkuara për riekportimin e pajisjeve në fjalë.

Neni 9

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

Marrëveshja financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

PËR KOMISIONIN

PËR PËRFITUESIN

z. D.Meganeck
Drejtor

znj. Arenca Trashani
Ministër i Integritit Europian

Rezervë: Për sa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi për palën shqiptare në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

MINISTRE E INTEGRIMIT EUROPIAN
Arenca Trashani

SHTOJCA I KUSHTET E PËRGJITHSHME

TITULLI I FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1

Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2

Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve të përgjithshme.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen financiare, Komisioni mund, ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II ZBATIMI

Neni 3

Parime të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4

Periudha e ekzekutimit

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të kushteve specifike.

4.2 Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza:

- një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kryesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe do të përfundojë 24 muaj përpara fundit të kohës së ekzekutimit;

- faza e mbylljes gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllet teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.3 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.4 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.6 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe, rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III
LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5

Parime të përgjithshme

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme, në fuqi në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6

Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes financiare

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra e shumta deri në datën e caktuar në nenin 5 të kushteve specifike. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të kushteve specifike, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7

Pranueshmëria

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregullues të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazën e kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financiar, duhet ta kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI IV
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8

E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tendera për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9

Normat tatimore dhe doganore

9.1 Përveç rasteve ku parashikohet në kushtet speciale, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10

Normat mbi kursin e këmbimit

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jo diskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11

Përdorimi i të dhënave nga studimet

Aty ku Marrëveshja financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12

Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

TITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13 **Transparenca**

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme, në fuqi në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14 **Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit**

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe, me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, i cili shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të Komuniteteve Europiane, ose nga çdo zë i pajustificuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që lidhet me;

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve ose deklaratave të rreme, jo korrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre ose në emër të tyre;

- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;

- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të.

"Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiarë të Komuniteteve Europiane.

"Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premtos ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiarë të Komuniteteve Europiane.

Neni 15

Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiarë të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato u nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin, OLAF ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Llogarive.

Neni 16

Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes financiare.

Neni 17

Ndryshimet në Marrëveshjen financiare

17.1 Çdo ndryshim në kushtet speciale dhe shtojcën II të Marrëveshjes financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuar nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4 (5) dhe (6) i këtyre kushteve të përgjithshme.

Neni 18

Pezullimi i Marrëveshjes financiare

18.1 Marrëveshja financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes financiare në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja financiare.

Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen financiare, në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

Marrëveshja financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi, dhe që nuk mund t'i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme, pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale ose vonesat për t'i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj, në qoftë se nuk ka mundur t'i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 19

Përfundimi i Marrëveshjes financiare

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojë Marrëveshjen financiare me dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të këtyre kushteve, atëherë Marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 20

Rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njëres prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një arbitër brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës për arbitrat.

Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në Rregullat Fakultative të Arbitrimit për Organizatat Ndërkombëtare dhe shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA 2 KUSHTET TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

Programi i veprimit vjetor të programit CARDS Rajonal 2005	
1. Identifikimi	
Zëri i buxhetit	22.05.01 Asistencë për vendet e Ballkanit Perëndimor
Kosto totale	47.9 Mln Euro
Baza ligjore	Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2666/2000 ¹
2. Situata në rajon	

Procesi i Stabilizim-Asociimit mbetet politika kuadër për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në procesin e përafrimit me Bashkimin Europian. Këshilli i Kopenhagenit i dhjetorit 2002 konfirmoi perspektivën europiane të 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor, gjë që u rikonfirmua nga Këshilli Europian i Selanikut në qershor 2003. Bashkëpunimi rajonal përbën një nga shtyllat ndërtuese të këtij procesi.

Raporti vjetor për procesin e Stabilizim-Asociimit për Europën Juglindore u botua nga Komisioni në mars 2004. Raporti jep një vlerësim të progresit të vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë e Malit të Zi, duke përfshirë edhe Kosovën sipas përcaktimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, për sa i përket këtij procesi.

Që nga momenti i publikimit të raportit, një sërë zhvillimesh politike kanë ndodhur në rajon. Kroacia ka marrë statusin e vendit kandidat në qershor 2004 dhe, ndërsa negociatat nuk kanë filluar ende, vendi që nga 1 janari 2005 gëzon të drejtën e përfitimit të ndihmës së dhënë nga instrumentet e paraaderimit. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, e cila ka aplikuar për anëtarësi në mars 2004, i ka dhënë tashmë përgjigje pyetësorit të dorëzuar nga presidenti Prodi në tetor 2004. Përgjigjet të cilat i janë dorëzuar presidentit Barroso dhe Komisionerit Rehn në 14 shkurt 2005, po shqyrtohen nga shërbimet e Komisionit.

Mbështetja e përqaesjes Twin Track çoi në përgatitjen e Raportit të Fizibilitetit për "Përgatitjen e Serbisë dhe Malit të Zi për negociimin e një marrëveshjeje Stabilizim-Asociimi me BE-në". Ky raport, i cili u botua nga Komisioni në prill 2005 thekson se ky i fundit e konsideron Serbinë dhe Malin e Zi mjaftueshmërisht të përgatitur për të negociuar një MSA. Komisioni gjithashtu ka nxjerrë një komunikatë në lidhje me perspektivën europiane të Kosovës në prill 2005 dhe ka hapur një zyrë lidhëse në Prishtinë gjatë mesit të vitit 2004.

¹ OJ L 7.12.2000, fq.1, Rregullorja e amenduar së fundmi nga Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2257/2004 e datës 20.12.2004 (OJ L 389, 30.12.2004 fq 1)

Raporti i pSA i vitit 2004, i referohet gjithashtu progresit thelbësor që është arritur në bashkëpunimin rajonal. Ky bashkëpunim po materializohet nga dialogu intensiv politik midis vendeve të rajonit, si dhe progresi specifik në fusha të rëndësishme si drejtësia dhe çështjet e brendshme, e cila adreson sfidat e luftës kundër krimit të organizuar; dhe infrastrukturës, ku progres domethënës është arritur me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në fushat kritike të energjisë dhe transportit. Në dhjetor vendet anëtare të BE-së dhe 11 vendet e Europës Juglindore ranë dakord mbi parimet bazë për një traktat të energjisë së Komunitetit, i cili adreson çështje rregullatore, të tregtisë, ekonomike dhe të mjedisit.

Si shtojca të raportit të pSA u përfshinë edhe seti i parë i partneriteteve europiane, të cilat identifikojnë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme të cilat vendet duhet të adresojnë. Partneritetet për vendet kandidate potenciale u adoptuan nga Këshilli Europian në qershor 2004 dhe ai i Kroacisë në shtator të po atij viti. Prioritetet e partneriteteve do të jenë gjithashtu baza për programimin e asistencës e cila jepet nga programi CARDS. Në fund të 2004-ës, Komisioni aprovoi programet MIP për vendet e procesit, si dhe programin rajonal, të gjitha për periudhën 2005-2006 duke plotësuar dokumentet strategjike për vendet dhe MIP-et e aprovuara në vitin 2001.

Raporti i pSA i ka kushtuar vemendje edhe efekteve të masave të tregtisë autonome të dhëna nga BE-ja për vendet e rajonit. Analiza tregon një potencial domethënës të pashfrytëzuar, i cili mund të çojë në rritje të vëllimit të eksporteve nga vende të rajonit. Për të shfrytëzuar këtë potencial të nënkuptuar, vendet duhet të thithin nivele të mjaftueshme investimesh si një mjet për të zgjeruar bazën e tyre të eksportit.

Për të përfunduar, Kroacia përfiton nga asistenca e paraaderimit Phare, ISPA dhe SAPARD që nga janari 2005. Gjithsesi Kroacia mbetet pjesë e pSA-së dhe mbulohet gjithashtu edhe nga fonde CARDS rajonal (me përjashtim të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar që do të mbulohen nga instrumenti i paraaderimit).

3. Përmbledhje e Programit të Veprimit

Objektivi i përgjithshëm i Programit të Veprimit Rajonal 2005 është mbështetja për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në pSA dhe në veçanti dimensionin e tij rajonal. Ky program i veprimi rajonal reflekton Dokumentin Strategjik Rajonal (RSP) 2002-2006 dhe Programin Indikativ Shumëvjeçar (MIP) e dytë 2005-2006 të aprovuara tashmë.

MIP-i rajonal 2005-2006 identifikon prioritetet si më poshtë, ku fondet rajonale CARDS do të fokusohen për periudhën e referuar:

1. Ngritja institucionale (ngritja e kapaciteteve administrative, duke përfshirë përafrimin me *Acquis*, reforma në administratën publike, bashkëpunimi me agjencitë komunitare). Kjo fushë prioritare justifikohet nga dimensionin rajonal i instrumenteve të implementura, pra dimensionin rajonal i veprimeve të propozuara ose fakti që asistenca në këtë fushë mund të jepet në mënyrë më eficiente në nivel rajonal, dhe arsyetimeve operacionale, veprime të vazhdueshme dhe/ose plotësuese të filluara tashmë në këtë fushë.

2. Drejtësia dhe çështjet e brendshme (rritje e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit, tregues të harmonizuar për vlerësimin e sigurisë publike, situatën e krimit dhe instrumentet matëse) me fokus në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe që të korrespondojë me konsideratat dhe angazhimet politike të bëra nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky prioritet është i lidhur me natyrën e sfidave që duhen përballuar, domethënë natyrën transnacionale të krimit të organizuar dhe lidhjet midis këtij të fundit dhe korrupsionit, të cilat kërkojnë kundërveprime rajonale dhe ndërkombëtare, dhe arsyetimeve operacionale-të sigurohet vazhdimësi ose plotësim për veprimet e filluara nën MIP-in e mëparshëm.

3. Bashkëveprimi ndërkufitar. Ky prioritet është rajonal për nga vetë natyra e tij dhe gjithashtu korrespondon me angazhimet politike të bëra nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Ai lidh inisiativën e lançuar nga Komisioni Europian të Instrumentit të Fqinjësisë së Re (programe bashkëpunimi me fokus në kufijtë e jashtëm të BE-së). Ky do të plotësohet nga një komponent bashkëpunimi ndërkufitar në kufijtë e brendshëm të rajonit, mbështetur nga CARDS nën pSA. Në këtë fushë, organizatat e shoqërisë civile lokale do të luajnë një rol mjaft të madh.

4. Zhvillimi i sektorit privat. Ky prioritet është përcaktuar në bazë të objektivave të politikës-zhvillimi ekonomik duke qenë një qëllim përfitues për politika të tjera në rajon edhe për arsye të dimensionit rajonal të sfidës që duhet adresuar: ky veprim ka si qëllim konkret thithjen e investimeve të huaja direkte.

5. Zhvillimi i infrastrukturës (transporti, energjia, mjedisi, shoqëria e informacionit). Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë rënë dakord përsa i përket përqasjeve të përbashkëta thelbësore në infrastrukturën rajonale. Kjo fushë prioritare korrespondon me një dimension të fuqishëm rajonal duke parë nevojën që rajoni të perceptohet si një hapësirë ekonomike e përbashkët për operatorët e huaj.

Ashtu siç tregohet edhe në MIP-in rajonal 2005-2006, disa veprime të MIP-it rajonal të mëparshëm 2002-2004 nuk u përfshinë për t'u adresuar në 2005-ën dhe 2006-ën. Ky është rasti me mbështetjen në fushën e menaxhimit të kufijve pasi tashmë kjo duhet të menaxhohet në nivel kombëtar. MIP-et kombëtare 2005-2006 do të mbulojnë gjithashtu fushën e stabilitetit demokratik, ndërkohë që kthimi i refugjatëve do të mbështetet kryesisht nga zhvillimi social-ekonomik i drejtuar ndaj zonave me popullatë të madhe minoritare dhe me aktivitetete të pakta ekonomike. Për sa i përket promovimit të tregtisë, masat do të merren kryesisht në nivel kombëtar, duke i lënë pjesës rajonale veprimet e nevojshme për të mbështetur aktivitete specifike rajonale. Kjo shpjegon pse këto 2 aktivitete nuk janë propozuar në programin rajonal.

Struktura e programit rajonal 2005 ndjek strukturën e MIP-it dhe adreson 5 fushat prioritare të identifikuar në të: ngritja e institucioneve, drejtësia dhe çështjet e brendshme, bashkëveprimi ndërkufitar, zhvillimi i sektorit privat dhe i infrastrukturës. Fushat përkatëse të sektorëve janë paraqitur nëpër anekset që e shoqërojnë atë.

Veprimet e propozuara brenda këtyre fushave prioritare korrespondojnë me prioritetet e identifikuar në MIP-in rajonal dhe janë zgjedhur në përputhje me kriteret e kuadrit cilësor të relevancës, fizibiliteti, efektivitetit dhe menaxhimit: veprimet e propozuara janë në përputhje të plotë me prioritetet e MIP-it dhe korrespondojnë me prioritetet e pSA për vendet e përfshira në të. Ato marrin në konsideratë kuadret e politikave të vendeve dhe statusin e implementimit të projekteve/iniciativave ekzistuese në nivel kombëtar dhe rajonal. Veprimet e propozuara janë identifikuar gjithashtu me qëllimin për të shpërndarë përfitime të prekshme dhe të qëndrueshme për target-grupet me një vlerësim të hamendësimeve dhe rreziqeve dhe kur është e nevojshme, identifikimin e kushtëzimit paraprak të nevojshëm për lançimin e veprimeve. Për më tepër, instrumentet e implementimit të mirëprovuara, tashmë ekzistuese, do të përdoren, në disa raste të aplikimit të vendeve candidate, për të siguruar sinergji dhe ekonomi të shkallës.

Ky program veprimi konsiston në projektet në fushat prioritare si më poshtë:

Ngritja e institucioneve

Objektivi është të kontribuojë për të rritur kapacitetet e administratave publike të vendeve të Ballkanit Perëndimor të ndërrmarin detyrimet e tyre nën PSA dhe në veçanti të rrisë aftësitë e tyre për të përshtatur legjislacionin vendas me EU *Acquis* dhe zbatimin e tij. Ai kërkon gjithashtu të rritë kapacitetet e përgjithshme administrative të vendeve për sa i takon funksionimit të shtetit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, si dhe përgjegjësinë përpara qytetarëve. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që nëpunësit civilë të administratave të zhvillojnë dhe të kuptojnë parimet dhe praktikatat më të mira të administratave të vendeve anëtare të KE-së.

Kjo duhet të arrihet nëpërmjet studimeve teknike, trajnimeve të specializuara dhe misionëve. E gjithë kjo duhet të jetë si shtesë e aktiviteteve të zhvilluara në nivel kombëtar, nëpërmjet organizimit të evenimenteve rajonale, seminareve dhe riekzaminimeve, duke përfshirë përfaqësues nga vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor në të njëjtën kohë.

Propozohet që të përdoren instrumente ekzistuese si TAIEX dhe SIGMA, të cilat kanë demonstruar tashmë dobishmërinë e tyre në mbështetje ndaj vendeve aderuese. Kjo përqasje do të ndihmojë për të përfituar në mënyrë maksimale nga eksperiencat tashmë ekzistuese dhe për të arritur sinergji dhe ekonomi të shkallës.

Për sa i përket Shkollës Rajonale për Administratën Publike, duke ndjekur edhe rekomandimet e konkluzioneve të Selanikut, hapa të mëtejshëm për ngritjen e një shkolle transnacionale për administratën publike do të ndërmerren.

Mbështetja në këtë sektor ka si qëllim gjithashtu të rrisë nivelin e të kuptuarit dhe vazhdimësinë në rastin e Agjencisë Europiane të Mjedisit, të përmbajtjes së punës dhe funksionimit të agjencive komunitare kyçe, puna e të cilave mund të jetë e rëndësishme për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për këtë prioritet, ndërhyrjet e mëposhtme janë parashikuar:

- ngritja e kapaciteteve administrative, duke përfshirë përafrimin e legjislacionit, duke marrë pjesë në aktivitete të implementuara nga TAIEX.

- mbështetje për reformën në administratën publike dhe në veçanti aspekteve të lidhura me kontrollin financiar, auditimin dhe menaxhimin financiar, prokurimin publik dhe administrimin e taksave-SIGMA

- Shkolla Rajonale e Administratës Publike; Faza I: nisja e një kompleti të parë evenimentesh edukuese.

- përgatitja për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në agjenci të specializuara komunitare. Follow-up për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në aktivitetet e Agjencisë Europiane të Mjedisit.

Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Objektivi i përgjithshëm i veprimeve të propozuara në këtë seksion është të sjellë mekanizmat tashmë ekzistues të bashkëpunimit rajonal p.sh. SECI konform zhvillimeve dhe praktikave më të mira të BE-së, si dhe të ndërtojë platformat kombëtare për bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë.

Veprimet e propozuara kanë si qëllim të përfitojnë në maksimum nga aktivitete tashmë ekzistuese në nivel rajonal, p.sh. SECI dhe/ose nën asistencën e siguruar nga programet CARDS ose donatorë të tjerë p.sh. mbështetja ndaj zyrave qendrore kombëtare. Komplementaritetet do të arrihet me mbështetjen substanciale të sektorit si pjesë e programeve kombëtare.

Për nga vetë natyra e sektorit, implementimi do të jetë subjekt i një numri kushtesh siç është shpjeguar edhe në fushën e sektorit. Përsa i takon mekanizmave të bashkëpunimit rajonal është me rëndësi që mekanizmat e propozuar/zhvilluara të jenë në përputhje të plotë me praktikën brenda BE-së. Një parakusht për çdo lloj bashkëpunimi ndërkombëtar të policisë do të jetë gjithashtu puna paraprake e nevojshme dhe marrëveshja për sa i përket përdorimit dhe mbrojtjes së të dhënave për shkëmbim.

Dy projekte të identifikuar në MIP 2005-2006 nuk janë propozuar si pjesë e Programit Rajonal 2005.

Ato kanë të bëjnë me bashkëpunimin e gjyqësorit, ku tashmë është duke u zbatuar një projekt, i cili adreson: legjislacionin e BE-së, bashkëpunimin dhe krijimin e rrjeteve, ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve kombëtare dhe sidomos ngritja e një rrjeti rajonal prokurorësh. Ky projekt me një shumë prej 5 mln eurosh është duke prodhuar rezultate të vlefshme dhe pritet që të zgjasë deri në mesin e vitit 2007. Lançimi i aktiviteteve shtesë në këtë fazë do të vinte në rrezik kapacitete absorbuese të limituara të administratave kombëtare të gjyqësorit. Propozohet që kjo të adresohet në programin tjetër për vitin 2006. Projekti tjetër i treguar në MIP ka të bëjë me identifikimin e një numri treguesish për policinë dhe gjyqësorin. Një punë parapërgatitore jashtë këtij programi mund të lançohet me mbështetjen e fondeve të 2005-ës, duke pasur si qëllim propozimin e një veprimi të detajuar gjatë programimit të vitit tjetër.

Për këtë prioritet, ndërhyrjet e mëposhtme janë parashikuar:

- mbështetje ndaj qendrës së SECI-it si një mekanizëm për bashkëpunimin rajonal të policisë;

- mbështetje për ngritjen ose promovimin të qendrave kombëtare të koordinimit, me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe hetimeve ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ndërkuftar

Objektivi i përgjithshëm i aktiviteteve të këtij prioriteti është mbështetja ndaj bashkëpunimit në nivel rajonal dhe lokal si brenda rajonit të CARDS-it, ashtu edhe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare dhe kandidatë të BE-së, duke përforcuar kështu një ndër objektivat kyç të CARDS-it, atij të promovimit të bashkëpunimit rajonal, transnacional dhe ndërkuftar. Veprimi i propozuar ka si qëllim gjithashtu të vazhdojë mbështetjen ndaj programeve të fqinjësisë të lançuara në 2004-ën.

Fakti që Kroacia ka fituar të drejtën për të marrë fonde nga ndihma e paraaderimit që nga janari i vitit 2005, duke përfshirë edhe Phare CBC, ka çuar në përfundimin se kontributet për pjesëmarrjen e saj në programet e fqinjësisë do të financohen nga Phare CBC. Është kjo arsyeja që shuma e parashikuar për këtë vit për kontributin e CARDS-it në programet e fqinjësisë do jetë 12.2 mln në vend të 15 mln të parashikuar fillimisht. Kjo shifër është llogaritur duke deduktuar kontributin e CARDS-it nga programi. Interreg Sllovaki/Hungari/Kroaci dhe duke reduktuar në mënyrë propocionale kontributin e programeve me shumë vende si Itali-Adriatik dhe CADSES.

Për këtë prioritet, ndërhyrjet e mëposhtme janë parashikuar:

- kontribut i mëtejshëm për programet e fqinjësisë;
- bashkëpunimi ndërkuftar PSA;

Zhvillimi i sektorit privat

Objektivi i përgjithshëm i veprimeve të propozuara në këtë fushë është stimulimi i potencialit thelbësor të pashfrytëzuar të Masave Autonome të Tregtisë (ATM) dhe lehtësojë thithjen e investimeve të huaja direkte në rajon. Kjo duhet të arrihet duke rritur ndërgjegjësimin për mundësitë e ofruara nga ATM-të dhe stimulojë konkurrencën e operatorëve ekonomikë në rajon, si dhe të lehtësojë dialogun e tyre me homologët e tyre në vendet anëtare të BE-së. Gjithashtu objektivi është të identifikojë sektorët target në rajon dhe të rrisë aftësitë e tyre për marrjen në konsideratë të investuesve të huaj potencialë.

Ky veprim ka si qëllim të përfitojë në maksimum nga asistenca e dhënë tashmë dhe nga aktivitetet tashmë ekzistuese, të cilat promovojnë potencialin për investime të huaja në rajon.

Për këtë prioritet, ndërhyrjet e mëposhtme janë parashikuar:

- promovimi i investimeve;
- mbështetje ndaj biznesit/tregtisë dhe organizatave të promovimit të investimeve.

Zhvillimi i infrastrukturës

Objektivi i përgjithshëm i veprimeve të propozuara nën këtë prioritet është inkurajimi dhe përsheptimi i investimeve në strukturën transkuftare (transporti, energjia dhe mjedisi). Kjo do të bëhet nëpërmjet përgatitjes së një faciliteti për përgatitjen e projekteve e cila do të lehtësojë investimet IFI në rajon.

Ai do të bazohet në punën përgatitore të bërë tashmë nën kujdesin e Grupit Drejtues të Infrastrukturës për sa i përket identifikimit të projekteve të prioritetit rajonal të cilat kanë mundësinë të thithin investimeve dhe janë të avancuara në mënyrë të mjaftueshme në tre fushat e sipërpërmendura. Një mekanizëm i vetëm fleksibël multisektorial për të reduktuar kostot administrative është parashikuar pa ndarje në sektor paraprakisht.

Projekti i dytë do të ketë si qëllim vazhdimin e mbështetjes për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në REREP, i cili është aktualisht duke iu afruar fundit në shtator 2006.

Kushtëzimi në lidhje me veprimin e parë do të lidhet me mbështetjen e dhënë ndaj projekteve me karakter rajonal dhe të favorshëm për investimet. Një mekanizëm aprovimi do të ngrihet, në diskutim me ISG-në, për të siguruar që projektet e financuara nga ky facilitet të korrespondojë me prioritetet rajonale dhe që ka ngjashmeri të jenë të favorshme për investimet. Për sa i takon veprimin të dytë dhe me qëllim rritjen e aftësive të marrjes në pronësi të aktiviteteve, bashkëfinansim nga burime të tjera duhet të kërkohet.

2 projekte të identifikuara në MIP 2005-2006 nuk janë propozuar për t'u përfshirë në këtë program rajonal. E para ka të bëjë me energjinë, ku mbështetja për Komunitetin e Energjisë për EJK është lançuar. Për sa i përket shoqërisë së informacionit, pavarësisht rëndësisë strategjike të saj, është shumë herët, për arsye të situatës së përgatitjes së përfituesve, të adresohen projekte rajonale në sektorin e ICT-së.

Gjithsesi, një tjetër linjë buxheti tashmë ekzistuese e CARDS-it mund të përdoret për të bërë studime fizibiliteti në mbështetje të programimit të asistencës së ardhshme rajonale. Përfshirje plotësuese e TAIEX-it do të kërkohej.

Për këtë prioritet, ndërhyrjet e mëposhtme janë parashikuar:

- faciliteti i përgatitjes së projekteve për transportin, energjinë dhe ambientin;
- mbështetje e mëtejshme për sekretariatit e REREP.

Implementimi

Programi rajonal i veprimit CARDS 2005 do të implementohet nga Komisioni Europian në përputhje me nenin 53(1) të rregullores së Këshillit (EC, Euroatom) nr.1605/2002 të datës 25.6.2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

Ndërhyrjet e mëposhtme do të implementohen në përputhje me nenin 53 (1) të rregullores financiare:

- OBZHE (OECD) do të implementojë ndërhyrjen e SIGMA-s parashikuar në sektorin e ngritjes së institucioneve;
- REC do të implementojë veprimin në fushën e ambientit, parashikuar në sektorin e infrastrukturës.

Pjesë të programit në fushën e bashkëpunimit rajonal do të ekzekutohen nga Agjencia Europiane për Rindërtim në përputhje me nenin 53(2) të rregullores financiare dhe nenit 4(1) dhe 7(2a) të Rregullores së Këshillit nr.2666/2000 të 5 dhjetorit 2000.

Përveç sa më sipër, me qëllim që të implementohen ndërhyrjet e tjera të parashikuara në fishat e sektorit, kontrata për thirrje për propozime dhe asistencë teknike mund të konkludohen për të siguruar shërbime. Kontrata për pajisje mund të konkludohen për pajisje të specializuara. Informacion i mëtejshëm sigurohet në fishat përkatëse të sektorëve.

Kontratat për shërbimet, punimet dhe pajisjet duhet të konkludohen në përputhje me procedurat e tenderimit dhe kontraktimit të parashikuara në rregulloren financiare dhe instruksionet të tjera relevante.

Përpjekje do të bëhen për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë për marrjen e pronësisë së programit rajonal nga administratat e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një eveniment rajonal u zhvillua në Shkup në prill 2005, në të cilën morën pjesë delegacionet e KE-së dhe përfaqësues të autoriteteve kombëtare dhe mendohet të organizohen edhe të tjera çdo 6 muaj. Ky program do të monitorohet dhe supervizohet nga shërbimet e KE-së.

Llogaritë dhe veprimet e komponentëve të programit mund të kontrollohen në intervale nga një auditor i jashtëm i kontraktuar nga Komisioni pa paragjykime për përgjegjësitë e KE-së, duke përfshirë këtu Zyrën Europiane të Antimashtrimit (OLAF) dhe Gjykatën e Llogarive të BE-së.

4. Asistenca e kaluar e KE-së dhe mësimet e nxjerra

Periudha e programit/viti	Të alokuara (euro)	Të kontraktuara* (euro)	Të paguara (Euro)
CARDS rajonal 2002	43.5	40.90	19.13
CARDS rajonal 2003	31.5	20.95	8.13
CARDS 2004 (NP)	15	0	0

* Të kontraktuara deri në korrik 2005

Në menaxhimin e programeve me shumë vende, një numër pikash të përgjithshme kanë dalë për sa i përket mësimëve të nxjerra, të cilat janë të një rëndësie të veçantë në programin rajonal:

- nevoja për të pasur një vlerë të shtuar të qartë për sa i përket dimensionit rajonal;
- nevoja për një sipërmarrje gjithnjë në rritje nga autoritetet kombëtare dhe delegacionet e KE-së/EAR për të siguruar komplementaritet me aktivitetet kombëtar;
- përqendrim në një numër të reduktuar sektorësh;

- konsideratë aktiviteteve të filluara tashmë për të siguruar vazhdimësi dhe statusi aktual i implementimit për të shmangur mbivendosjet;

- pjesëmarrje e rritur e aktorëve kryesorë në këtë stad.

Aktivitetet e propozuara dhe metodat e sugjeruara të identifikimit/implementimit janë dizenuar duke marrë në konsideratë mësimet e nxjerra.

5. Veprime plotësuese

Ky program vjetor ka si qëllim të plotësojë veprimet e parashikuara në nivel kombëtar. Një analizë e detajur është bërë, sektor pas sektori, në të cilën situata aktuale si përsa i përket projekteve të implementuara, ashtu edhe zhvillimit të politikave është marrë në konsideratë. Në veçanti, programet e mëparshme rajonale janë përdour si inpute për këtë program.

Kroacia merr pjesë tashmë me fonde kombëtare në një numër programesh. Fokusi i veçantë në mbështetjen rajonale të administratës publike është për të siguruar që aktivitetet e financuara nën buxhetin rajonal të korrespondojnë me aktivitetet e karakterit rajonal, të cilat përfshijnë disa vende të PSA-së në të njëjtën kohë, duke përfshirë këtu edhe Kroacinë. Me përjashtim të rastit të bashkëpunimit ndërkuftar të paguara nga Phare, Kroacia është e përfshirë në të gjitha aktivitetet nën këtë program rajonal.

Vende të tjera të rajonit mund të ndodhen në të njëjtën situatë gjatë periudhës së implementimit të programit.

6. Koordinimi donatorëve

Koordinimi i donatorëve për sa i përket autoriteteve kombëtare, do të sigurohet nga delegacionet e KE dhe EAR si pjesë e takimeve të tyre në vend. Për më tepër, misioni i programimit do të përfshijë diskutime me autoritetet kombëtare dhe aktorët kryesorë.

Termet e referencës për implementimin e projekteve do të diskutohen me delegacionet-EAR, të cilat do të verifikojnë përmbajtjen duke iu referuar bakgrundeve kombëtare.

Për të konkluduar, Komisioni mban takime të rregullta koordinuese me aktorët kryesorë në nivel rajonal si p.sh. me IFI-n nëpërmjet grupit të punës Inter-service.

7. Kostot dhe financimi

Përmbledhje e alokimeve për programin e veprimit 2005

Projekti	Buxheti në milion Euro 2005
Ngritja e institucioneve	13.5
Ngritja e kapaciteteve administrative duke përfshirë përafrimin e legjislacionit-TAIEX	6
Reforma e administratës publike-SIGMA	4
Shkolla e administratës Publike	1
Agjencitë komunitare	2.5
Drejtësia dhe çështjet e brendshme	2.2
Mbështetje për qendrën e SECI-t	1
Njësitë bashkëvepruese të implementimit të ligjit	1.2
Bashkëveprimi ndërkuftar	17.2
Programet e fqinjësisë	12.2
Bashkëveprimi ndërkuftar-pSA	5
Zhvillimi i sektorit privat	3
Promovimi i investimeve	2
Mbështetje për biznesin, tregtinë, dhe agjencitë/organizatat e promovimit të investimeve	1
Zhvillimi i infrastrukturës	12
Faciliteti i përgatitjes së projekteve të infrastrukturës	10
Mjedisi	2
Totali	47.9

L I G J
Nr. 9572, datë 3.7.2006

PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që në vijim do të quhet “Autoriteti”.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja:

- a) e tregut të titujve dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në tituj e që veprojnë në këtë treg;
- b) e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- c) e tregut të pensioneve suplementare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare, të ofruara nga institutet private të pensioneve suplementare;
- ç) e veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare jobankare”.

KREU II
STATUSI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 3
Statusi i Autoritetit

Autoriteti është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë, i specializuar për të rregulluar e mbikëqyrur veprimtarinë e subjekteve, që ushtrojnë një ose disa nga veprimtaritë e përmendura në nenin 2 të këtij ligji.

Autoriteti, për veprimtarinë që ushtron, në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

Neni 4
Bordi i Autoritetit

Organi vendimmarrës i Autoritetit është Bordi, i cili përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 nënkryetarë dhe 4 anëtarë të tjerë.

Neni 5
Kërkesat për t'u emëruar anëtar i Bordit

Anëtarët e Bordit janë:

1. Shtetas shqiptarë.
2. Me arsim të lartë ekonomik, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.
3. Me përvojë të paktën 3-vjeçare në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së

bashku:

- a) financë-kontabilitet;
- b) administrim i shoqërive tregtare;
- c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
- ç) hartim legjislativ;
- d) shkencë e aktuarëve;
- dh) sigurime shoqërore dhe pensione.
4. Me integritet moral dhe profesional.
5. Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.
6. Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykatë të formës së prerë.
7. Kur plotësojnë kërkesat e dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

Kryetari dhe nënkryetarët e Bordit nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjetër me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore-shkencore apo pjesëmarrjes në organizata vendase apo ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit.

Katër anëtarët e tjerë të Bordit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk lejohen të jenë anëtarë të më shumë se 1 bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Çdo anëtar i Bordit ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara në këtë nen.

Neni 6
Emërimi i anëtarëve të Bordit

Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi.

Kryetari, dy nënkryetarët dhe 2 prej anëtarëve të Bordit emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Ministri i Financave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të Ministrave nga një kandidat për anëtar të Bordit të Autoritetit. Kandidati i propozuar nga Banka e Shqipërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kandidati i propozuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Këshilli i Ministrave, në bazë të dy kandidaturave të veta, si dhe të kandidatëve të propozuar nga Ministri i Financave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, harton propozimet për Kuvendin.

Në propozim përcaktohet edhe funksioni që kandidatët do të kenë në Bordin e Autoritetit. Në rastin e nënkryetarëve, në propozim përcaktohet edhe departamenti që do të drejtojë secili prej tyre.

Kuvendi, me vendimin e emërimit të secilit prej nënkryetarëve, përcakton edhe departamentin, që do të drejtojë secili prej tyre.

Neni 7

Mandati i anëtarëve të Bordit

Mandati i Kryetarit, i dy nënkryetarëve dhe i anëtarëve të bordit është 5 vjet. Në rastet kur mandati i Kryetarit, nënkryetarit ose anëtarit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në çastin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit, Autoriteti lajmëron me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikën për zgjedhjen e anëtarit të ri.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mund të rizgjidhen për një mandat të dytë pas përfundimit të mandatit të tyre. Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pas përfundimit të mandatit nuk mund të rizgjidhet për një mandat të dytë në detyrën e Kryetarit të Bordit.

Në përfundim të mandatit, anëtari i Bordit nuk mund të punësohet për një periudhë dyvjeçare apo të përfshihet në shërbime me pagesë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga ndonjëri prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.

Individi, që ka qenë i emëruar në detyrën e Kryetarit ose të nënkryetarit të Bordit dhe i ka mbaruar mandatin, pas largimit nga detyra, kur nuk është i punësuar, përfiton për një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që ka pasur, kur ka qenë në detyrë. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individi i riemëruar anëtar i Bordit, si dhe ai që është liruar nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 8

Lirimi nga detyra i anëtarit të Bordit

Kuvendi vendos lirimin nga detyra të anëtarit të Bordit përpara afatit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 7 të këtij ligji, në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
- c) për shkak të rrethanave të reja nuk respektohen kërkesat e parashikuara në pikat 5 e 6 të paragrafit të parë të nenit 5, si dhe kushtet e parashikuara në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 5 të këtij ligji;
- ç) në rast të mungesës pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;
- d) gjatë ushtrimit të funksioneve vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;
- dh) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të tij si institucion i pavarur;
- e) humbet nënshtetësinë shqiptare.

Propozimi për lirimin nga detyrara të anëtarit të Bordit i paraqitet Kuvendit nga vetë Bordi ose nga secili prej institucioneve, që kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të Bordit, si dhe nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit. Në propozimin për largimin e anëtarit përcaktohen arsyet dhe provat në lidhje me rastin. Kuvendi mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit. Kuvendi, pas shqyrtimit, vendos lirimin ose jo nga detyra të anëtarit.

Në rast të liritimit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit përpara afatit, anëtari tjetër emërohet me të njëjtën procedurë, siç është emëruar anëtari që lirohet, për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet.

Neni 9

Kompetenca në miratimin e strukturës dhe të pagave të Autoritetit

Paga mujore e Kryetarit të Bordit, e nënkryetarëve dhe shpërblimi për anëtarët e tjerë, që nuk kryejnë funksione ekzekutive në Autoritet, miratohet nga Kuvendi, me propozimin e Bordit të Autoritetit.

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi, me propozimin e Bordit të Autoritetit.

Autoriteti, përveç njësive të tjera, është i përbërë nga 2 departamente kryesore. Emërtimi i këtyre departamenteve dhe i njësive të tjera të Autoritetit përcaktohet në përputhje me strukturën e Autoritetit.

Bordi miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet e veçanta dhe përgjegjësitë e departamenteve dhe të drejtorive, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre, si dhe përgjegjësitë e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë.

Neni 10

Mbledhjet e bordit

Mbledhjet e Bordit thirren me nismën e Kryetarit ose me kërkesën e secilit prej anëtarëve drejtuar Kryetarit të Bordit. Bordi mblidhet të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe vendosur për rendin e ditës.

Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë, nga njëri prej nënkryetarëve të autorizuar prej tij.

Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 4 anëtarë.

Vendimet e Bordit janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 4 anëtarë.

Në votim nuk lejohet abstenimi.

Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e Bordit nënshkruhen nga Kryetari dhe nga nënkryetari përgjegjës për çështjen, për të cilën është marrë vendimi. Në rast se vendimi është i natyrës së përgjithshme, ai nënshkruhet nga Kryetari dhe nga të dy nënkryetarët.

Bordi miraton rregulloren për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Neni 11

Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

Bordi njofton publikisht politikat dhe praktikat që ndjek për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe arsyet e ndryshimit të tyre.

Politika që ndjek për zbatimin e dispozitave, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përfshijnë edhe mjetet e zgjedhura nga Autoriteti dhe të përdorura në mënyrë të pavarur prej tij, gjatë përmbushjes së objektivave të këtij ligji.

Autoriteti miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni.

Bordi miraton rregulloren për mënyrën dhe afatet e botimit të tyre, si dhe për hartimin dhe funksionimin e faqes së Autoritetit në internet.

KREU III

OBJEKTIVAT, KOMPETENCAT E AUTORITETIT DHE TË DREJTAT E BORDIT

Neni 12

Objektivat e Autoritetit

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, Autoriteti udhëhiqet nga këta objektiva:

1. Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar.
2. Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jobankare.
3. Sigurimi i respektimit të ligjit.

Neni 13

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit

Autoriteti me strukturat e veta ka si objekt të veprimtarisë:

1. Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore, të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligjet e fushës, si dhe botimin e udhëzimeve e materialeve shpjeguese.

2. Sigurimin e mbikëqyrjes shtetërore mbi tregun e titujve, tregun e sigurimeve, skemat e pensioneve suplementare dhe veprimtari të tjera financiare jobankare, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet në fuqi.

Në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, Autoriteti ka të drejta të plota për:

a) miratimin, lëshimin apo refuzimin e licencave për subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërën prej tregjeve financiare jobankare;

b) vëzhgimin dhe organizimin e mbikëqyrjes së subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në njërën prej tregjeve financiare jobankare. Subjektet, qofshin këta individë apo persona, fizikë ose juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e përmenduar në nenin 2 të këtij ligji, në vijim do të quhen “subjekte të mbikëqyrura”.

c) ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij e të ligjeve të fushës dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Neni 14

Kompetencat e Bordit

Bordi ka këto kompetenca:

1. Harton, në përputhje me strukturën, rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.

2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.

3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.

4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, që rregullojnë fushën e veprimtarisë dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

5. Miraton formatin e licencave, që lëshohen për ushtrimin e veprimtarive të mbikëqyrura nga Autoriteti.

6. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në njërën prej tregjeve financiare jobankare, të mbikëqyrura nga Autoriteti. Në zbatim të kësaj kompetence, Bordi:

a) miraton ose refuzon, në përputhje me afatet, kushtet dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për titujt, prospektusin për ofertën publike ose për regjistrimin e emetimeve të reja për shitje, sipas rregullave të tregut të titujve;

b) mbikëqyr zbatimin e vendimeve të përkohshme apo përfundimtare për botimin e ofertave publike të titujve;

c) miraton licencat e individëve apo të personave fizikë ose juridikë, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve, përfshirë këtu veprimtari, si treg titujsh, tregtarë të titujve, regjistruar, depozitarë, ndërmjetës apo këshilltarë investimesh, si dhe të subjekteve të tjera të përfshira në treg;

ç) miraton licencat e shoqërive, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari, si administrues të fondeve të investimit dhe licencat për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi;

d) jep pëlqimin për statutin, organet e larta drejtuese, si dhe ndryshimet e statutit të shoqërive, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve, përpara se të paraqiten në gjykatë;

dh) miraton, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, licencat për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit e të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari;

e) shqyrton kërkesat për zgjerim veprimtarie, të bëra nga subjektet e licencuara;

ë) shqyrton kërkesat për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ato për hapjen e zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja që ushtrojnë veprimtari të lidhura me objektin e funksionimit të Autoritetit;

f) shqyrton kërkesat për transferim portofoli, si dhe për dhënien në sipërmarrje të disa prej funksioneve të shoqërisë së sigurimit;

g) miraton bashkimin ose ndarjen e shoqërive të licencuara të sigurimit;

gj) miraton organet e larta drejtuese, statutin e shoqërive të sigurimit dhe ndryshimet në statut, përpara se ai të paraqitet për miratim në asamblenë e përgjithshme të aksionerëve;

h) shqyrton kërkesat për pjesëmarrje influencuese në shoqëritë e sigurimit dhe në investimet e kapitalit të shoqërive të sigurimit;

i) miraton likuidimin vullnetar dhe vendos fillimin e procedurave të falimentimit për shoqëritë e sigurimit;

j) miraton organet e larta drejtuese, statutin dhe ndryshimet në statutin e shoqërive, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari si institute private pensionesh, përpara regjistrimit të tyre në gjykatë;

k) ndërmerr masa korrigjuese, të përshtatshme dhe në kohën e duhur, në rastet kur shoqëria e sigurimit apo e risigurimit nuk arrin nivelin e kërkuar të aftësisë paguese ose kur vërehen raste të mosplotësimit të aftësisë paguese, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe të risigurimeve;

l) miraton udhëzues metodologjikë, formën e kontratës së sigurimit, lista, tipe shkresash dhe dokumente të tjera për veprimtarinë e instituteve private të pensioneve;

ll) miraton rregulloret e instituteve private të pensioneve suplementare dhe ndryshimet në këto rregullore, si dhe kontrollon zbatimin e tyre;

m) miraton llojin, formën dhe përmbajtjen e raporteve, që i paraqiten Bordit nga subjektet e licencuara;

n) miraton transferimin e paketës kontrolluese të subjekteve të mbikëqyrura.

7. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërisë së sigurimit dhe të shoqërisë së risigurimit, kur vërtetohet se investimet nuk janë në përputhje me raportet rregullatore të vendosura apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.

8. Shqyrton, brenda 1 muaji nga paraqitja e kërkesës, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, që shoqëria e sigurimit kërkon të hedhë në treg.

9. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.

10. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.

11. Miraton listën e ekspertëve kontabël, që mund ta ushtrojnë këtë funksion në shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jobankare.

12. Merr vendim për rastet e parashikuara në ligj, për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe kur kjo parashikohet nga ligji, emëron likuidatorin.

13. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të nëpunësve dhe të të punësuarve të tjerë të Autoritetit.

14. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit, në funksion të veprimtarisë së Autoritetit.

15. Diskuton periodikisht raportet për veprimtarinë e departamenteve kryesore të Autoritetit.

16. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të Autoritetit.

17. Miraton, brenda muajit qershor të çdo viti, raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut, të mbikëqyrur nga Autoriteti.

18. Miraton, në rregulloret për procedurat e brendshme administrative, afatet për paraqitjen e çështjeve për shqyrtim.

19. Miraton manualët e inspektimit.

20. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jobankar.

21. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.

22. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e nëpunësve dhe punonjësve të tjerë të administratës.

23. Kompetenca të tjera, të parashikuara nga ky ligj apo nga ligjet e fushës.

Vendimet e marra janë objekt ankimimi në gjykatë.

Vendimet administrative të Bordit botohen në format e vendosura nga Bordi për botimin e njoftimeve zyrtare.

Neni 15

Kompetencat e Kryetarit të Bordit

Kryetari i Bordit kryen edhe funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv. Ai organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti, me përjashtim të veprimtarive, që janë në kompetencë të nënkryetarëve apo anëtarëve të tjerë të Bordit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Kryetari i Bordit ka këto detyra:

1. Përfaqëson Autoritetin.

2. Thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit.

3. Bashkërendon punën e nënkryetarëve.

4. Propozon raportin e pagave të nëpunësve e të punonjësve të tjerë të administratës.

5. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.

6. Organizon punën për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim para Bordit të projektbuxhetit.

7. Organizon punën për zbatimin e buxhetit, mbylljen e vitit financiar dhe raportin financiar, si dhe i paraqet ato për miratim përpara Bordit.

8. Nënshkruan kallëzimet penale, në rastet e zbulimit të të dhënave për veprime ose mosveprime, që përbëjnë vepër penale.

9. Shkëmben të dhëna me Bankën e Shqipërisë, me institucione e agjenci të tjera qeveritare, me autoritete dhe administrata vendore, me organizata jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari të lidhura me tregjet financiare jobankare, të mbikëqyrura nga Autoriteti, si dhe subjektet e mbikëqyrura.

10. Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, me urdhër të përbashkët urdhëron kryerjen e inspektimeve në bankat depozitare për veprimtaritë e subjekteve të licencuara nga Autoriteti e që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jobankare, të mbikëqyrura nga Autoriteti.

11. I kërkon Bankës së Shqipërisë të ndërmarrë inspektime me objekt të caktuar në bankat e nivelit të dytë, në përputhje me ligjin “Për bankat”, si dhe vë në dijeni për rezultatet e kontrollit.

12. Ngre komitete këshillimore, që ta mbështesin gjatë ushtrimit të funksioneve.

Neni 16

Kompetencat e nënkryetarëve

Kompetencat e nënkryetarëve përcaktohen në rregullat për përshkrimin e punës, të miratuara nga Bordi.

Nënkryetarët e Bordit, sipas përcaktimit të dhënë në vendimin e emërimit, janë secili drejtues i njërit prej dy departamenteve kryesore të Autoritetit. Brenda kompetencave ligjore, nënkryetari organizon, drejton dhe përgjigjet për punën e departamentit që drejton.

Neni 17

Kompetencat e anëtarëve, që nuk kanë funksione ekzekutive

Katër anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione drejtuese në Autoritet, kur kërkohet shqyrtimi i një çështjeje të veçantë, lidhur me mangësi apo shkelje të vërejtura gjatë veprimtarisë së Autoritetit dhe të strukturave të tij, funksionojnë si komitete kontrolli. Këta anëtarë shqyrtojnë dokumentacionin dhe përgatisin raporte të hollësishme, të cilat ia paaqesin Bordit.

Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë.

Komiteti i kontrollit mund të emërojë njërin nga anëtarët e vet si raportues, i cili shqyrton apelimet dhe ankesat ndaj vendimeve të Bordit.

Raportuesi gëzon të gjitha të drejtat për të kryer inspektim të plotë rreth çështjes. Për vendimet e apeluara, raportuesi përgatit raporte të hollësishme dhe ia paraqet ato Bordit. Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë për rregullimin e gjendjes.

Bordi shqyrton raportin e paraqitur dhe vendos për masat e propozuara nëse ka të tilla.

Kuvendi vendos, nëse është e nevojshme, caktimin e auditit të jashtëm të Autoritetit.

Neni 18

Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit

Në ushtrimin e të drejtave të Bordit dhe të strukturave të tjera të Autoritetit, anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e ngarkuar për mbikëqyrjen gëzojnë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe me detyrën e ngarkuar, këto të drejta:

1. Kërkojnë nga subjektet e mbikëqyrura dhe subjektet e tjera, që kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve që rregullojnë tregjet e fushës, shpjegime me shkrim, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara dokumentesh, të dhëna, si dhe verifikojnë dokumentacionin dhe raportimet e bëra. Dokumentacioni dhe të dhënat e shkruara duhet të jenë në gjuhën shqipe.

2. Marrin të dhëna për fondet dhe asetet, përfshirë titujt, në pronësi të subjekteve të mbikëqyrura.

3. Inspektojnë llogaritë, dokumentet tregtare dhe çdo dokumentacion tjetër, që ka lidhje me transaksionet e kryera.

4. Kryejnë verifikime në palë të treta, të cilat përfshijnë vetëm shqyrtimin e asaj pjese të dokumentacionit apo të veprimtarisë së palës së tretë, që ka lidhje me çështjen për të cilën është inspektuar subjekti i mbikëqyrur.

5. U kërkojnë palëve të treta të dhëna, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara, të njësuara të dokumenteve, deklarata mbi llogaritë dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për realizimin e verifikimeve.

6. Marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga strukturat drejtuese dhe kontrolluese të subjekteve të mbikëqyrura.

Për zbatimin e procedurave të mbikëqyrjes, nënkryetari përgjegjës për subjektin e mbikëqyrur mund t'i kërkojë Bordit emërimin e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me kërkesat specifike të miratuara nga Bordi. Shpenzimet, në këtë rast, përballohen nga subjekti i mbikëqyrur.

Me kërkesë të Kryetarit të Bordit, bankat janë të detyruara që, për subjektet e mbikëqyrura, t'i japin Autoritetit të dhëna për numrat dhe kodet e llogarive ekzistuese apo të mbyllura, si dhe datën e transaksionit të fundit të kryer.

Të gjitha të dhënat dhe dokumentet, që përbëjnë shkelje të këtij ligji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre emrin e personit, që është marrë me hartimin e tyre, u dorëzohen palëve të treta nga Kryetari i Bordit vetëm me miratimin paraprak të personit në fjalë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Policia, prokuroria dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore detyrohen që, brenda kompetencave të tyre, të ndihmojnë Autoritetin dhe punonjësit e tij për përmbushjen e detyrave gjatë ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave të ngarkuara nga ky ligj, Autoriteti mund të ndër marrë inspektime të përgjithshme, në bashkëpunim me organet e tatim-taksave.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit, si dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij nuk janë financiarisht përgjegjës për dëmet, që mund të shkaktojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, me përjashtim të rasteve kur ata kanë kryer një krim apo kanë kryer veprime të qëllimshme.

Neni 19 **Inspektimi**

Inspektimi ushtrohet nga nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e nënshkruar nga Kryetari ose, në mungesë dhe me autorizimin e lëshuar prej tij, nga njëri prej nënkryetarëve. Inspektimi bëhet me ose pa lajmërim.

Nëpunësit e urdhëruar, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, inspektojnë për:

1. Respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve financiare jobankare.

2. Parandalimin dhe identifikimin e shkeljeve.

Për ushtrimin e inspektimit, subjekti i mbikëqyrur është i detyruar t'u sigurojë nëpunësve të Autoritetit kushte normale pune, si dhe t'u ofrojë dokumentacion ose çdo të dhënë tjetër, të shkruar në gjuhën shqipe.

Nëpunësit e administratës së Autoritetit, para fillimit të procedurave të inspektimit, janë të detyruar të paraqesin urdhrin e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Subjekti i mbikëqyrur është i detyruar t'u ofrojë Autoritetit dhe administratës së tij:

a) mjetet e nevojshme për inspektim, nëse i kërkohet kjo, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve në mjediset e Autoritetit;

b) personat e kontaktit, nga radhët e të punësuarve, për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;

c) hyrje pa limit në mjediset e zyrave;

ç) të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat, në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi;

d) pas një kërkesë paraprake, fotokopjet e llogarive dhe të dokumenteve të tjera, ku të shënohet me shkronja shtypi "E njëjtë me origjinalin", si dhe data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar nga personi i inspektuar.

Raporti për çdo inspektim përgatitet në dy kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit, që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundërfirmë personit që përfaqëson subjektin e mbikëqyrur.

KREU IV **ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES**

Neni 20 **Organizimi dhe detyrimet**

Veprimtaria e Autoritetit mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme të përshkrimit të punës dhe me rregulloret e tjera për funksionimin e administratës, të cilat miratohen nga Bordi, sipas propozimit të Kryetarit.

Marrëdhëniet e punës me nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të kësaj administrate rregullohen sipas Kodit të Punës.

Nuk mund të punësohen në strukturat e Autoritetit persona:

- a) të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
- b) të cilët janë ortakë apo aksionerë të subjekteve të mbikëqyrura;
- c) që kanë qenë anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura në dy vitet e fundit;
- ç) që kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “c” të këtij neni, me anëtarët e Bordit apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje hierarkike;
- d) që janë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura;
- dh) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional dhe për të cilët janë marrë masa disiplinore për cenim të rregullave të etikës.

Neni 21

Shpërblimi i administratës

Rregullat e brendshme për raportet e pagave, pagat mujore të punonjësve të Autoritetit dhe shpërblimet përcaktohen nga Bordi, sipas propozimit të Kryetarit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

KREU V

DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 22

Konflikti i interesit

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurisë në çastin e marrjes së detyrës, si dhe më tej, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Anëtarët e Bordit nuk marrin pjesë në procedurat e diskutimit, votimit dhe vendimmarrjes, nëse kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare.

Nëpunësi i Autoritetit nuk merr pjesë në inspektime ndaj subjekteve të mbikëqyrura nëse ka interesa, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për çështjen për të cilën kryhet inspektimi, interes i cili cenon paanësinë e tyre.

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit, nëse vërejnë se ndodhen përpara rastit të parashikuar, përkatësisht, në paragrafin e dytë ose të tretë të këtij neni, bëjnë deklaratat me shkrim për këtë fakt dhe tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes.

Në rast se vërehet se megjithëse janë ndodhur përpara rastit të përmendur, përkatësisht, në paragrafin e dytë apo të tretë të këtij neni dhe nuk kanë bërë deklarin përkatës e për pasojë nuk janë tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, ndaj tyre merret masa e lirimit ose e largimit nga detyra. Masa e lirimit ose e largimit nga detyra nuk ndikon në vendimet e marra deri në atë çast.

KREU VI

KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 23

Kodi etik dhe profesionalizmi

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale, të miratuara nga Bordi, sipas propozimit të Kryetarit.

Kur vërehen shkelje të kodit të etikës, merren masa disiplinore deri në lirimin ose largimin nga detyra.

Neni 24
Konfidencialiteti

Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen “Informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit.

Nuk janë informacione konfidenciale të dhënat tregtare, të siguruar nga subjekti i mbikëqyrur, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuar nga Bordi.

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale.

Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimin nga detyra, për anëtarët e Bordit, ose largimin nga detyra, për nëpunësit e tjerë të Autoritetit.

Neni 25
Përfundimi i trajtimit si informacion konfidencial

Informacioni i klasifikuar konfidencial nuk trajtohet më si i tillë me kalimin e tre viteve nga çasti kur i është dorëzuar Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Bordit.

Bëjnë përjashtim nga respektimi i afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni rastet kur ky informacion kërkohet nga:

1. Autoritetet gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Autoritetet mbikëqyrëse bankare apo shërbimet inteligjente, sipas kriterëve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje të përbashkëta.
3. Autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera, që ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme me atë të Autoritetit, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta për shkëmbim të dhënash, kur këto autoritete:

- a) sigurojnë të paktën të njëjtin nivel konfidencialiteti për të dhënat që dërgohen;
- b) bien dakord që, me kërkesë të Autoritetit, të vënë në dispozicion të njëjtën të dhënë;
- c) kanë arsye për kërkesën për informacion.

Në dhënien e këtij informacioni zbatohen dispozitat ligjore për të dhënat personale.

Të dhënat e marra nga subjekti i mbikëqyrur mund t’i rijepen atij në çdo kohë.

KREU VII
FINANCIMI DHE BUXHETI I AUTORITETIT

Neni 26
Financimi dhe buxheti

Autoriteti është institucion i pavarur, që kryesisht financohet nga burimet e veta, por, për çdo diferencë ndërmjet burimeve të fondeve dhe shpenzimeve të veprimtarisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes financohet nga Buxheti i Shtetit deri në çastin kur të ardhurat janë të mjaftueshme për të siguruar funksionimin normal të tij. Pjesa e financimit nga Buxheti i Shtetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si pjesë e pavarur e Buxhetit të Shtetit. Teprica e buxhetit për vitin financiar kalon në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar, me përjashtim të fondeve të destinuar për investimet, të cilat janë në proces.

Të ardhurat në buxhetin e Autoritetit krijohen nga:

1. Pagesat sipas nenit 27.
2. Të ardhurat nga sanksionet në zbatim të legjislationit në fuqi për fushën e tregjeve financiare jobankare.

3. Shitjet e botimeve periodike.
4. Financimet nga Buxheti i Shtetit.
5. Burime të tjera dhe veprimtari të lejuara nga ky ligj dhe nga legjislacioni në fuqi për tregjet financiare jobankare.

Pasqyrat financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve hartohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Autoriteti, për përdorimin e fondeve të veta, u nënshtrohet dispozitave ligjore për prokurimet publike.

Neni 27

Pagesat

Autoriteti mbledh pagesa për:

1. Dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive, në përputhje me ligjin “Për letrat me vlerë”, ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe ligjin “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”.

2. Miratimin e prospektit të ofertës publike.

3. Miratimin e vendimit të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, për vënien në likuidim të një shoqërie, që ushtron veprimtari si institut pensionesh.

4. Miratimin e lejes shtesë për ushtrim të veprimtarive, që përfshijnë një tip të ri ose paketë të re sigurimi.

5. Shoqëritë e sigurimit, si kontribute në masën deri në 1,5 për qind të primeve bruto, të arkëtuara nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jojetës dhe kuotave të fituara nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jetës. Prime bruto, të arkëtuara nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jojetës dhe kuotat e fituara nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jetës, certifikohen nga audit i jashtëm, i pavarur, i shoqërisë së sigurimit. Rakordimi i kontributeve të kësaj pike, sipas shifrave të certifikuara nga audit i jashtëm, i pavarur, kryhet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i certifikatës së auditimit.

6. Shoqëritë e pensioneve suplementare si prim vjetor, i cili duhet të jetë në një përqindje të caktuar, jo më shumë se 1,5 për qind e kontributeve.

7. Rishikimin e dokumentacionit për botimin e deklaratave apo të njoftimeve për çështjet e përmendura në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij paragrafi.

Lista e pagesave miratohet me ligj nga Kuvendi.

Pagesa, për efekte tatimore, raportohet si një llogari shpenzimesh të subjektit të mbikëqyrur.

Kryetari i Bordit nxjerr urdhrin për mbledhjen e pagesave, që u ka kaluar afati i likuidimit. Ankimimi i vendimit të Bordit nuk e pezullon ekzekutimin e tij. Pagesat, nëse vlerësohen të tepërta, i kthehen subjektit të mbikëqyrur.

KREU VIII

KONTABILIZIMI DHE KONTROLLI I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT

Neni 28

Raportimi dhe kontrolli

Brenda muajit prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet Kuvendit:

1. Raportin vjetor për veprimtarinë e tij.
2. Deklarimin për gjendjen financiare vjetore.
3. Raportin për realizimin e planit të buxhetit.

Raport vjetor për veprimtarinë e Autoritetit, përveç të dhënave që mund të kërkohen nga Kuvendi, përmban të dhëna për:

1. Përshtatshmërinë e infrastrukturës ligjore të tregut financiar të mbikëqyrur.

2. Vendimet e marra për dhënien e licencave, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, refuzimin e lëshimit të licencave apo të kërkesave të tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, regjistrimet e bëra në regjistra, vendimet e ankimua të Bordit dhe, në mënyrë të hollësishme, ankimimet e vendimeve të Bordit, të cilat janë pranuar nga gjykata.

3. Rezultatit e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura.

4. Politikat e ndjekura për vënien në dijeni të publikut, si dhe ato të bashkëpunimit të brendshëm e ndërkombëtar.

5. Organizimin, financimin dhe politikat për përzgjedhjen e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë.

6. Të dhëna të tjera, sipas vendimit të Bordit.

KREU IX REGJISTRAT E AUTORITETIT

Neni 29 Regjistrat

Autoriteti mban regjistra të hapura për publikun për:

1. Shoqëritë, që ushtrojnë veprimtaritë si tregje të titujve (bursa).

2. Shoqëritë publike dhe emetuesit e tjerë të titujve.

3. Shoqëritë e investimit.

4. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe institutet private të pensioneve.

5. Fondet e investimit.

6. Tregtarët e titujve dhe këshilltarët e investimeve.

7. Shoqëritë e sigurimeve.

8. Agjentët e sigurimeve.

9. Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si institute private të pensioneve.

Bordi, me propozimin e Kryetarit, miraton regjistra të tjerë dhe procedura për regjistrimin fillestar, mbajtjen dhe ruajtjet e regjistrave, si dhe procedurat që sigurojnë mirëfunksionimin e regjistrat, si një sistem informativ i plotë.

KREU X GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR (GKSF)

Neni 30 Funksionimi i GKSF-së

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, më poshtë GKSF, krijohet si një njësi këshillimore që:

1. Asiston në zhvillimin e politikave të përbashkëta, në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve të anëtarëve të këshillit sa herë që është e nevojshme të kryhen inspektime në subjektet e mbikëqyrura.

2. Siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të grupit.

3. Asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

4. Asiston në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesëmarrësit e tregjeve financiare.

Anëtarë të GKSF-së janë:

- Ministri i Financave;

- Kryetari i Bordit të Autoritetit;

- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Me ftesë të GKSF-së, në mbledhjet e tij mund të marrë pjesë edhe Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe persona të tjerë.

GKSF-ja i bën secilit prej përfaqësuesve rekomandime dhe propozime, që kanë si qëllim përmirësimin e praktikave të plotësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës ligjore për tregjet financiare.

Të drejtën për të thirrur mbledhjen e GKSF-së e ka çdo anëtar.

Mbledhjet e GKSF-së kryesohen nga Ministri i Financave. Mbledhja e parë e GKSF-së thirret nga Ministri i Financave brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU XI SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 31 Gjobat

Cilido person, që pengon Autoritetin e Mbikëqyrjes, strukturat e tij ose nëpunësit e autorizuar të administratës së tij në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga ky ligj ose nga çdo akt tjetër, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Çdo shkelje, sipas paragrafit të parë të këtij neni, e kryer nga persona që janë ortakë ose aksionerë të personit juridik, që kanë funksione drejtuese të personit juridik apo nga ortakë të vetëm të një shoqërie tregtare, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë dhe në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Sanksionet administrative, të vendosura nga Bordi, sipas këtij neni, dhe njoftimi për vendimin e marrë nënshkruhen nga Kryetari i Bordit. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Bordit.

KREU XII KOMPETENCA E AUTORITETIT PËR ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Neni 32 Përdorimi i masave administrative

Bordi, për parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Autoritetit, mund të miratojë vendime për subjektet e mbikëqyrura, të cilat duhet të trajtojnë mënyrën që duhet të ndjekin subjektet e mbikëqyrura për të korrigjuar situatën apo për të parandaluar dëmin. Këto vendime përcaktojnë afate për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e veprimeve, si dhe mund të parashikojnë detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve, në rastet kur vërehen veprime në kundërshtim me ligjin.

Autoriteti mund ta vërë në dijeni publikun për masat e marra në zbatim të paragrafit të parë të këtij neni.

KREU XIII DISPOZITA KALIMTARE

Neni 33 Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë kompetencat vendimmarrëse:

1. Të Komisionit të Letrave me Vlerë, të krijuar me ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar.

2. Të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, të krijuar me ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, të ndryshuar.

3. Të Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve, të krijuar me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar.

Mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve, i kalojnë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky proces përfundon në çastin e shkrirjes së administratës së tri institucioneve të para.

Tarifat e zbatuara deri tani nga Komisioni i Letrave me Vlerë, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Inspektorati i Insiteuteve Private të Pensioneve mbeten në fuqi dhe zbatohen nga Autoriteti deri në miratimin e pagesave, sipas nenit 27 të këtij ligji.

Neni 34

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë

Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet përgjegjëse paraqesin në Kuvend propozimet për anëtarët e Bordit.

Brenda 10 ditëve nga marrja e propozimeve, Kuvendi emëron anëtarët e Bordit.

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë bëhet sipas afateve të mëposhtme:

1. Kryetari 5 vjet.

2. Njëri prej nënkryetarëve 5 vjet dhe tjetri 4 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin e emërimit.

3. Anëtarët, përkatësisht njëri 5 vjet, njëri 4 vjet dhe dy të tjerët nga 3 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin për emërimin e tyre.

Kryetari thërret mbledhjen e parë të Bordit brenda 7 ditëve nga emërimi. Mbledhja e parë e Bordit organizohet në mjediset e përcaktuara në lajmërimin e thirrjes së bërë nga Kryetari.

Neni 35

Mbarimi i funksioneve dhe shkrirja e administratave të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari organet vendimmarrëse të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve, si dhe përfundon mandati i anëtarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet vendimmarrëse të këtyre institucioneve.

Licencat dhe vendimet e tjera individuale administrative, të lëshuara deri në datën e miratimit të këtij ligji nga organet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mbeten në fuqi.

Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shkrihen administratat e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe të Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari, sipas procedurave të miratuara nga Bordi, fillon punën për rekrutimin e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në këto institucione. Gjatë kësaj periudhe, personat që ushtrojnë funksione ekzekutive në këto administrata nuk kanë më asnjë kompetencë vendimmarrëse për lëshimin e licencave apo zgjerimin e tyre. Ata janë përgjegjës për dorëzimin të Kryetari i Autoritetit të mjeteve, burimeve të të ardhurave, arkivave dhe detyrimeve të tjera, të përmendura në paragrafin e fundit të nenit 33 të këtij ligji.

Nëpunësit e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Insiteuteve Private të Pensioneve, të cilët nuk do të rekrutohen nga Autoriteti, përfitojnë të drejtat e parashikuara nga ligji “Statusi i nëpunësit civil”.

Neni 36

Caktimi i pagave, shpërblimeve dhe strukturës për vitin e parë financiar

Struktura e Autoritetit, paga e Kryetarit, e nënkryetarit dhe shpërblimi i anëtarëve të tjerë të Bordit për vitin 2006 caktohen nga Këshilli i Ministrave brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 37

Buxheti i Autoritetit për vitin e parë financiar të veprimtarisë

Buxheti i Autoritetit për vitin 2006 hartohet mbështetur në buxhetin e Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve.

Ngarkohet Ministri i Financave të bëjë ndryshimet e nevojshme për përgatitjen e buxhetit të vitit 2006 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

KREU XIV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Terminologjia

Në këtë ligj, termat kanë të njëjtin kuptim si në ligjet që rregullojnë secilin prej tregjeve financiare jobankare, që janë objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti.

Në këtë ligj, termi “tituj” ka të njëjtin kuptim me termin “letra me vlerë”.

Neni 39

Hartimi i rregulloreve të Autoritetit

Bordi, brenda dy muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloren e parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 9 të këtij ligji.

Bordi, brenda 6 muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloret e tjera për drejtimin e përditshëm të institucionit.

Neni 40

Shfuqizime

Ligji nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, shfuqizohet.

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjeve nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar, nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar, dhe nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shfuqizohen.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rishqyrton dhe miraton të gjitha aktet nënligjore, të cilat miratoheshin nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni.

Neni 41

Ndryshimet në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, të ndryshuar

Në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë“ të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në ligj fjala “Komision” zëvendësohet me fjalën “Autoriteti”.
2. Kreu II dhe Kreu X shfuqizohen.
3. Pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 64 shfuqizohen.
4. Neni 67 shfuqizohet.

Neni 42

Ndryshimet në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 4 e 5 të nenit 1 shfuqizohen.
2. Në pikën 10 të nenit 1 dhe kudo në ligj, ku është përdorur, termi “depozitëmarrës” zëvendësohet me termin “depozitar”.
3. Në nenin 19 fjala “inspektorët” zëvendësohet me fjalët “nëpunësi i urdhëruar”.
4. Kudo në ligj fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.
5. Kudo në ligj emërtesa “Inspektorat ”zëvendësohet me emërtesën “Autoriteti”.
6. Kreu XI shfuqizohet.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4988, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) 1500**
-
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
 - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT 500**
- 2. KODI DOGANOR 1000**
- 3. KODI DETAR 1000**

Hyri në shtyp më 24.7.2006
Doli nga shtypi më 26.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë